Paneli këshillëdhënës për të drejtat e njeriut
Building D, UNMIK HQ, Prishtinë/Kosovë | E-mail: hrap-unmik@un.org | Tel: +381 (0)38 504-604, ext. 5182

VENDIM

Data e miratimit: 6 qershor 2013

Lënda nr. 08/10

Tomë KRASNIQI

kundër

UNMIK-ut

Paneli Këshillëdhënës për të Drejtat e Njeriut, i mbledhur më 6 qershor 2013,
me anëtarët vijues të pranishëm:

Z. Marek NOWICKI, Kryetar
Znj. Christine CHINKIN
Znj. Françoise TULKENS

Të ndihmuar nga
Z. Andrey ANTONOV, Zyrtar ekzekutiv

Pas shqyrtimit të ankesës së sipërpërmendur, të paraqitur në pajtim me nenin 1.2 të Rregullores së UNMIK-ut nr. 2006/12 të datës 23 mars 2006 mbi themelimin e Panelit Këshillëdhënës për të Drejtat e Njeriut,

Pas diskutimeve vendosi si në vijim:

I. PROCEDURA PRANË PANELIT

1. Ankesa u parashtrua më 8 mars 2010 dhe u regjistrua në të njëjtën ditë.

2. Më 15 mars 2010 dhe 11 maj 2010, ankuesi i siguroi Panelit informacione shtesë.

3. Më 11 prill 2012, Paneli ia komunikoi rastin Përfaqësuesit Special të Sekretarit të Përgjithshëm (PSSP), për komentet e UNMIK-ut mbi pranueshmërinë e ankesës.

4. Më 12 prill 2012, ankuesi i dorëzoi Panelit dokumentacion plotësues. Ky dokumentacion plotësues më vonë ju komunikua PSSP-së më 14 maj 2012.

5. Më 31 maj 2012, PSSP-ja e ofroi përgjigjen e UNMIK-ut.

6. Më 26 shtator 2012, Paneli ia dërgoi ankuesit komentet e PSSP-së duke e ftuar atë të japë komente shtesë nëse dëshironte.

7. Ankuesi ia dërgoi përgjigjen e tij PSSP-së në një letër të datës 2 tetor 2012.

II. FAKTET

8. Ankuesi është banor i Kosovës i cili jeton në komunën e Pejës. I lindur në vitin 1938, ankuesi kishte paguar kontribute në Fondin Pensional Shtetëror të Republikës Federative të Jugosllavisë i cili quhej "Fondi Pensional dhe Invalidor", duke fituar të drejtën për pension nga 3 maji 1998. Ai thekson se kishte marrë një pension me një vlerë përafërsisht 180 euro në muaj nga kjo datë deri më 1 dhjetor 1998. Pas kësaj date, ky pension ishte ndalur pa i dhënë ndonjë njoftim paraprak apo sqarim ankuesit.

9. Deri më 1989, Krahina Autonome e Kosovës kishte një Fond Autonom Pensional që mblidhte kontributet dhe paguante përfitimet. Ky sistem, në atë kohë, ishte sistem solidariteti i gjeneratës, i njohur si sistem '*pay-as-you-go'*, përmes të cilit punëtorët aktivë paguanin kontribute për të financuar përfitimet e pensionistëve aktual. Pensionet administroheshin nga Fondi për Sigurimin Pensional dhe Invalidor që ishte i centralizuar në Beograd në vitin 1989.

10. Ankuesi thekson se pas ardhjes së UNMIK-ut në pajtim me Rezolutën e Këshillit të Sigurimit të KB-së 1244 (1999) ai, së bashku me shqiptarë të tjerë të Kosovës, ishin ndaluar të marrin këtë pension. Ankuesi thekson se serbët e Kosovës vazhduan të marrin këtë pension.

11. Pas pezullimit të pensionit jugosllav të ankuesit, me Rregulloren nr. 2001/35 mbi pensionet në Kosovë të datës 22 dhjetor 2001 dhe Rregulloren nr. 2005/20 të datës 19 prill 2005 për ndryshimin e Rregullores nr. 2001/35, UNMIK-u krijoi një skemë alternative pensionale që siguronte pensione "bazike" (të pleqërisë, jokontribues) dhe "të kursimeve" (kontribues) në Kosovë.

12. Nga dokumentacioni i paraqitur Panelit, duket se më 11 prill 2007 ankuesi ia drejtoi një ankesë Departamentit të administrimit të pensioneve në Kosovë (DAPK) në Ministrinë e Punës dhe Mirëqenies Sociale, me të cilën kërkonte pagimin e pensionit të fituar sipas ish sistemit jugosllav. Më 13 prill 2007, DAPK i dërgoi një përgjigje me shkrim ankuesit në të cilin thuhej se mospagimi i pensionit të fituar përmes kontributeve ishte për shkak të "fondeve të vjedhura nga uzurpuesit serbë" që përbënte një "problem të pazgjidhur politik", dhe ankuesin e informonte për skemat pensionale që ishin duke vazhduar të administrohen nga DAPK.

13. Duket se më 30 prill 2007, pas një ankese të paraqitur nga aplikanti më 16 prill 2007, DAPK nxori vendim me të cilin njohu të drejtën e ankuesit në pension të pleqërisë/bazik, "të fituar përmes kontributeve në Fondin Pensional dhe Invalidor nga

dhjetori i vitit 1998 e tutje". Ankuesi thekson se sipas këtij sistemi, nga një datë e papërcaktuar, ai ka pranuar një pension nga DAPK prej rreth 45 eurosh në muaj.

14. Më 4 maj 2007, ankuesi filloi procedurë ligjore në gjykatën komunale të Prishtinës kundër Ministrisë së Punës dhe Mirëqenies Sociale të Qeverisë së Kosovës, duke kërkuar "rikthimin e statusit të tij si pensioner kontribuues", pagesat e papaguara të shumave të cilat ai pretendonte se ia kishin borxh pas pezullimit të pagimit të pensionit dhe kompensimin e dëmeve të shkaktuara nga ky pezullim.

15. Deri në fund të vitit 2008, gjykata komunale e Prishtinës nuk e kishte kontaktuar ankuesin dhe nuk ishin caktuar seanca dëgjimore lidhur me padinë e lartcekur.

III. ANKESA

16. Ankuesi së pari ankohet se nga 12 dhjetori 1998 deri në prill 2007 ai nuk ka pasur mundësi të marrë pensionin e tij bazuar në vitet e kontributeve të tij në Fondin Pensional dhe Invalidor të ish Jugosllavisë. Ai fajëson UNMIK-un për mosgjetjen e zgjidhjes për këtë problem, ashtu që ai të vazhdojë marrjen e pensionit si "pensionist kontribuues". Ai pohon se kjo është shkelje e së drejtës së tij për gëzim të papenguar të pronës së tij në pajtim me nenin 1 të Protokollit nr. 1 të Konventës Evropiane për të Drejtat e Njeriut (KEDNJ).

17. Së dyti, ankuesi ankohet në esencë se për shkak të mospagesës së pensionit të tij "kontribues" gjatë periudhës nga 1999 deri më 2007, dhe për shkak të pensionit joadekuat të pleqërisë që atij i është dhënë më pas, ai ka mbetur pa mjete financiare për të mbajtur veten. Në këtë aspekt, Paneli mendon se ankuesi mund të konsiderohet se thirret në shkelje të së drejtës së tij për të mos u trajtuar në mënyrë johumane apo degraduese ashtu siç është garantuar me nenin 3 të KEDNJ, si dhe në shkelje të së drejtës së tij për sigurim social dhe në standard adekuat jetese, të garantuar me nenin 9 përkatësisht 11 të Konventës Ndërkombëtare për të Drejtat Ekonomike, Sociale dhe Kulturore (KNDESK).

18. Së treti, ankuesi ankohet për kohëzgjatjen e procedurës lidhur me kërkesën e tij pranë gjykatës komunale të Prishtinës. Në këtë aspekt ai mund të konsiderohet se thirret në shkelje të së drejtës së tij për të marrë vendim nga një gjykatë brenda një kohe të arsyeshme, në kuptim të nenit 6 § 1 të Konventës Evropiane për të Drejtat e Njeriut (KEDNJ).

19. Përfundimisht, ankesa ka të bëjë me shkeljen e pohuar të diskriminimit në trajtimin e pensionistëve shqiptarë dhe serbë të Kosovës të cilët jetojnë në Kosovë, duke shkelur nenin 14 të KEDNJ.

IV. LIGJI

20. Para se të shqyrtohet rasti për bazueshmërinë e tij, Paneli duhet të vendosë nëse do ta pranojë rastin, duke marrë parasysh kriteret për pranim të përcaktuara në nenet 1, 2 dhe 3 të Rregullores së UNMIK-ut nr. 2006/12.

A) Pohimi për shkelje të nenit 1 të Protokollit nr. 1 të KEDNJ

1. *Parashtresat e palëve*

21. Ankuesi ankohet se nuk e ka marrë pensionin kontribues që e ka fituar në kuadër të kornizës legjislative në fuqi në kohën e "ish Jugosllavisë", për periudhën 1999-2007.

22. Ai thekson se pas ardhjes së UNMIK-ut, atij dhe pensionistëve të tjerë shqiptarë të Kosovës u ishte ndaluar marrja e pensioneve të tyre kontribuese. Ai parashtron se fondet e grumbulluara nga kontributet e punëtorëve brenda atij sistemi "janë zhdukur" dhe se "nuk janë krijuar fonde të tjera për pensionistët shqiptarë". Në këtë aspekt, ankuesi pohon se "menjëherë pas luftës në vitin 1999, autoritetet e UNMIK-ut është dashur t'i ndihmojnë atij që të merr pensionin rregullisht"dhe thekson se UNMIK-u do të mbahet përgjegjës për "keqmenaxhimin" e kësaj çështjeje.

23. Sa i përket shkeljes së pohuar të së drejtës pronësore të ankuesit, PSSP-ja thekson se, për t'u mbrojtur sipas nenit 1 të Protokollit nr. 1 të KEDNJ, pasuria në fjalë duhet të definohet në mënyrë "adekuate". Për rrjedhojë, të drejtat pensionale mund të kualifikohen si "pronë" për qëllimet e KEDNJ, ku përmes pagimit të kontributeve, në fond krijohet një aksion individual, lartësia e të cilit mund të përcaktohet në çdo moment të caktuar". PSSP-ja argumenton se meqë UNMIK-u nuk i ka "të gjitha të dhënat e skemës apo detajet e kontributeve të dhëna nga ankuesi", ai nuk është në pozicion të komentojë për pranueshmërinë e nenit 1 të Protokollit nr. 1 të KEDNJ, dhe e rezervon të drejtën të japë komentet e UNMIK-ut për këtë çështje në një fazë të mëvonshme.

24. PSSP-ja gjithashtu thekson se shkelja e pohuar për të cilën është parashtruar ankesë ka të bëjë me të drejtat në pension që janë fituar përmes kontributeve pensionale dhënë fondeve shtetërore pensionale të ish Jugosllavisë dhe/ose RFJ-së, dhe se fondet e tilla administrohen "nga autoritetet në Beograd". PSSP-ja gjithashtu thekson se për përfshirjen e përgjegjësisë së shtetit shkelja e nenit 1 të Protokollit nr. 1 të KEDNJ kërkon që faktet për të cilat është parashtruar ankesë të jenë rezultat e ushtrimit të autoritetit shtetëror. Sipas PSSP-së, UNMIK-u nuk kishte "asnjë obligim ligjor t'u paguante pensione personave të cilët kanë fituar të drejtat në pension përmes institucioneve të tjera". Prandaj, përderisa ankuesi ankohet kundër privimit nga prona e tij, kjo shkelje i atribuohet RFJ-së ose Serbisë, dhe si e tillë të shpallet nga Paneli jashtë juridiksionit të tij *ratione personae*.

25. Gjithashtu, PSSP-ja thekson se UNMIK-u nuk ka obligim sipas nenit 1 të Protokollit nr. 1 të "gjejë zgjidhje" për çështjen e pensioneve në Kosovë, e cila, sipas mendimit të tij, është çështje politike e cila do të zgjidhet "në mes të Prishtinës dhe Beogradit me mbështetjen e palëve ndërkombëtare". Sipas PSSP-së, edhe pse Rezoluta e Këshillit të Sigurimit nr. 1244 (1999) parasheh që përgjegjësitë e UNMIK-ut të përfshijnë lehtësimin e një procesi politik të hartuar për përcaktimin e statusit të ardhshëm të Kosovës, kjo përgjegjësi nuk mund të interpretohet si një obligim "për gjetjen e një zgjidhjeje" për problemin e pensioneve.

26. Përfundimisht, PSSP-ja argumenton se ankuesi nuk ka siguruar dëshmi se ai ka ndërmarrë hapa për të marrë pagesën e pensionit të tij nga autoritetet e Serbisë; në veçanti ai nuk ka parashtruar ankesë kundër Serbisë në Gjykatën Evropiane për të Drejtat e Njeriut, që sipas PSSP-së do të përbënte një mjet të efektshëm, duke pasur parasysh se Serbia është palë e KEDNJ që nga viti 2004. Për këtë arsye, kjo pjesë e ankesës shpallet e papranueshme në pajtim me nenin 3 të Rregullores së UNMIK-ut nr. 2006/12 për mos-shterim të mjeteve juridike.

2. *Vlerësimi i Panelit*

27. Sa i përket vërejtjes së PSSP-së se mbrojtja e ofruar me nenin 1 të Protokollit nr. 1 zbatohet vetëm për pronat e "definueshme", dhe kur kemi të bëjmë me pensionet, vetëm për ato raste ku "me pagimin e kontributeve krijohet një aksion individual në fond, lartësia e të cilit mund të përcaktohet në çdo moment të posaçëm", Paneli i referohet praktikës gjyqësore të Gjykatës Evropiane për të Drejtat e Njeriut (GJEDNJ) mbi obligimin e shteteve sipas nenit 1 të Protokollit nr. 1 lidhur me zbatueshmërinë e tij për pensionet. Gjykata ka theksuar se kjo dispozitë nuk e garanton të drejtën për të marrë pension (shih GJEDNJ, Dhoma e Lartë [DHL], *Andrejeva kundër Letonisë*, nr. 55707/00, aktgjykim i 18 shkurtit 2009, § 77; GJEDNJ [DHL], *Stummer kundër Austrisë*, nr. 37452/02, aktgjykim i 7 korrikut 2011, § 82; GJEDNJ [DHL], *Slivenko kundër Letonisë*, nr. 48321/99, § 121 KEDNJ 2002-11, GJEDNJ [DHL], *Kopecký kundër Sllovakisë*, nr. 44912/98, 35 (b) KEDNJ 2004-XI, § 35(b)), ose çfarëdo e drejte në një lartësi të caktuar të pagimit të pensionit (GJEDNJ, *Maggio dhe të Tjerët kundër Italisë*, nr. 46286/09, 52851/08, 53727/08, 54486/08 dhe 56001/08, aktgjykim i 31 majit 2011, § 55). Mirëpo, Gjykata gjithashtu ka konsideruar se kur në fuqi është legjislacioni që siguron pagesën si një e drejtë në pension, ai legjislacion duhet të konsiderohet si "krijim i një interesi pronësor" që përfshihet në kuadër të nenit 1 të Protokollit nr. 1 për personat që plotësojnë kushtet e tij, dhe prandaj ulja ose ndërprerja e pensionit mund të përbëjë ndërhyrje në gëzimin e papenguar të pronës (shih GJEDNJ [DHL], *Carson dhe të Tjerët kundër Mbretërisë së Bashkuar*, nr. 42184/05, § 64, GJEDNJ 2010); GJEDNJ, *Rasmussen kundër Polonisë*, nr. 38886/05, 28 prill 2009, § 71; GJEDNJ, *Grudiç kundër Serbisë*, nr. 31925/08, 17 prill 2012, § 72).

28. Prandaj, Paneli konsideron se kjo pjesë e ankesës është në kuadër të juridiksionit lëndor të Panelit (*ratione materiae)* dhe e hedh poshtë kundërshtimin e PSSP-së në këtë aspekt.

29. Sa i përket argumentit të PSSP-së, për atë që ankesa ka të bëjë me ndërprerjen e pagesës nga "Fondi Pensional dhe Invalidor" me seli në Beograd, dhe duhet të shpallet e papranueshme *ratione personae*, Paneli thekson se kjo ankesë shprehimisht është drejtuar kundër UNMIK-ut, dhe se ankuesi ankohet se UNMIK-u si administratë e përkohshme në Kosovë nuk ka ndërmarrë masat e duhura që i ka pasur në kompetencë për t'i ndërmarrë për të siguruar pagimin e rregullt të pensionit të tij. Në fakt, Paneli konsideron se ankuesi pohon shkelje të obligimeve të UNMIK-ut që burojnë nga neni 1 i Protokollit nr. 1 lidhur me nenin 1 të KEDNJ, e cila kërkon që shtetet t'u "sigurojnë të gjithëve në kuadër të juridiksionit të tyre" gëzimin e të drejtave të garantuara me KEDNJ. Në këtë aspekt, Paneli i referohet praktikës gjyqësore të Gjykatës Evropiane duke thënë se ushtrimi efektiv i të drejtës së mbrojtur me nenin 1 të Protokollit nr. 1 "nuk varet vetëm nga detyra e shtetit që të mos ndërhyjë, por mund të kërkojë miratimin e masave pozitive të mbrojtjes", "veçanërisht kur ka lidhje direkte në mes të masave të cilat aplikanti ligjshmërisht mund t'i presë nga autoritetet dhe gëzimin efektiv të pronës së tij" (shih GJEDNJ *Öneryıldız kundër Turqisë* nr. 48939/99, aktgjykim i 30 nëntorit 2004, § 134).

30. Paneli është i ndërgjegjshëm se, si rregull e përgjithshme, nocioni "juridiksion" në kuptim të nenit 1 të KEDNJ duhet të konsiderohet se reflekton pozicionin e shtetit apo autoritetit në fjalë sipas të drejtës publike ndërkombëtare, dhe se ky nocion zakonisht përfshin fushën nën "kontrollin e përgjithshëm" të saj" (shih GJEDNJ, *Loizidou kundër Turqisë*, nr. 15318/89, aktgjykim i 18 dhjetorit 1996, § 56). Paneli thekson se, në

rrethanat e këtij rasti, dhe në pajtim me Rezolutën e Këshillit të Sigurimit të Kombeve të Bashkuara 1244 (1999), UNMIK-u ishte i mandatar, "në pritje të një zgjidhjeje përfundimtare", me administrimin e përkohshëm të Kosovës pa cenuar "sovranitetin dhe integritetin territorial të Republikës Federative të Jugosllavisë". Në këtë aspekt, Paneli i referohet praktikës gjyqësore të Gjykatës Evropiane se, në prani të një situate faktike që zvogëlon fushën e juridiksionit të autoritetit në fjalë - në këtë rast UNMIK-u *vis-à-vis* autoriteteve të Beogradit – "shteti në fjalë duhet bërë përpjekje, me të gjitha mjetet ligjore dhe diplomatike që i ka në dispozicion *vis-à-vis* shteteve të huaja dhe organizatave ndërkombëtare, të vazhdojë garantimin e të drejtave dhe lirive të garantuara me Konventën" (shih KEDNJ [DHL], *Ilaşcu dhe të Tjerët kundër Moldavisë dhe Rusisë*, aktgjykim i 8 korrikut 2004, § 333).

31. Për këto arsye, Paneli konsideron se ankesa sipas nenit 1 të Protokollit nr. 1 të KEDNJ është në kuadër të juridiksionit *ratione personae* të Panelit në pajtim me nenin 1.2 të Rregullores së UNMIK-ut nr. 2006/12 dhe e hedh poshtë kundërshtimin e PSSP-së në këtë aspekt.

32. Prandaj, Paneli konsideron se kjo pjesë e ankesës ngrit çështje faktike dhe juridike, vendosja e të cilave varet nga shqyrtimi i bazueshmërisë. Prandaj, Paneli konkludon se kjo ankesë nuk është e pabazuar në shikim të parë në kuptim të nenit 3.3 të Rregullores së UNMIK-ut nr. 2006/12.

33. Paneli nuk sheh ndonjë arsye tjetër për shpalljen e kësaj pjese të ankesës të papranueshme. Prandaj, Paneli e shpall të pranueshme ankesën sipas nenit 1 të Protokollit nr. 1 të KEDNJ.

B) Pohimi për shkelje të nenit 3 të KEDNJ

34. Ankuesi thekson se dështimi në zgjidhjen e të drejtave të tij në pension ka rezultuar me marrjen e ndihmës joadekuate nga UNMIK-u. Në mënyrë më specifike, pagesat e siguruara sipas skemës pensionale alternative kanë rezultuar me atë që ai të mos jetë në gjendje të gëzojë një standard adekuat jetese.

35. PSSP-ja argumenton në esencë se kjo pjesë e ankesës është e papranueshme *ratione personae*. PSSP-ja thekson se, përderisa ankesa ka të bëjë me pension joadekuat të pleqërisë të marrë nga ankuesi sipas skemës pensionale të Kosovës, mendohet se është e drejtuar kundër autoriteteve të Kosovës. Sipas PSSP-së "administrimi i skemës pensionale në Kosovë nga Ministria e Punës dhe Mirëqenies Sociale, është kompetencë e bartur dhe jashtë përgjegjësisë direkte të UNMIK-ut".

36. Në këtë aspekt, Paneli thekson se në Rregulloren e UNMIK-ut nr. 2001/35 *për pensionet në Kosovë* me të cilën u themelua skema e re pensionale e Kosovës, thuhej, në nenin 2.3, se "caktimi i politikave ekonomike lidhur me pensionin, si pjesë e politikave buxhetore dhe fiskale, mbetet nën mbikëqyrjen direkte të PSSP-së". Gjithashtu, Paneli tanimë e ka përcaktuar përgjegjësinë e UNMIK-ut, nga perspektiva e të drejtave të njeriut, për veprimet me të cilat ngarkohet një institucion i përkohshëm i vetëqeverisjes në Kosovë (shih Paneli Këshillëdhënës për të Drejtat e Njeriut (PKDNJ), *Spahiu*, nr. 02/08, mendim i pjesshëm i 20 marsit 2009, § 29), duke përfshirë edhe Ministrinë e Punës dhe Mirëqenies Sociale në Kosovë. Paneli gjithashtu ka konsideruar, si rregull e përgjithshme, se UNMIK-u e ka mbajtur këtë përgjegjësi deri në hyrjen në fuqi të Kushtetutës së Kosovës më 15 qershor 2008 (shih PKDNJ, *Kolë*

Krasniqi, lënda nr. 48/08, vendim i 13 marsit 2010). Prandaj, Paneli e hedh poshtë kundërshtimin e PSSP-së.

37. Sa i përket subjektit të ankesës, Paneli thekson se në këtë rast UNMIK-u me Rregulloren nr. 2001/35 krijoi një skemë pensionale në Kosovë përmes së cilës ankuesi ka marrë 45 euro në muaj. Ankuesi thekson se shuma e siguruar nuk ka qenë e mjaftueshme as për të blerë ilaçet për të cilat ai ka nevojë. Paneli përkujton praktikën gjyqësore të Gjykatës Evropiane për të Drejtat e Njeriut se një "ankesë për një shumë pensioni tërësisht të pamjaftueshme ose përfitim tjetër social, në parim, mund të ngrit një çështje sipas nenit 3 të KEDNJ që ndalon trajtimin johuman apo degradues" (shih GJEDNJ, *Larioshina kundër Rusisë*, nr. 56869/00, vendim i 23 prillit 2002, § 3). Paneli po ashtu thekson se sipas nenit 9 të Konventës Ndërkombëtare për të Drejtat Ekonomike, Sociale dhe Kulturore (KNDESK), shtetet kanë obligim të plotësojnë të drejtën e sigurimit social duke siguruar që "sistemi i sigurimit social të jetë adekuat" (shih Komiteti i të Drejtave Ekonomike, Sociale dhe Kulturore, Koment i Përgjithshëm nr. 19, e Drejta në Sigurim Social, E/C.12/GC/19, 4 shkurt 2008). Në mënyrë të ngjashme, në nenin 11 të KNDESK theksohet e drejta për një standard adekuat jetese.

38. Paneli konsideron se kjo pjesë e ankesës ngrit çështje faktike dhe juridike, vendosja e të cilave varet nga shqyrtimi i bazueshmërisë. Prandaj, Paneli konkludon se kjo pjesë e ankesës nuk është e pabazuar në shikim të parë në kuptim të nenit 3.3 të Rregullores së UNMIK-ut nr. 2006/12.

C) Pohimi për shkelje të nenit 6 § 1

39. Ankuesi thekson se nga 8 marsi 2010, data e dorëzimit të ankesës së tij pranë Panelit, gjykata komunale e Prishtinës nuk kishte marrë vendim për kërkesën e tij për t'ju kthyer statusi si pensioner "kontribues" dhe pagesat e papaguara të pensionit të tij. Paneli konsideron se ai mbështetet në nenin 6 të KEDNJ.

40. Në komentet e tij PSSP-ja thekson se kërkesa ishte parashtruar pranë gjykatës komunale në Prishtinë më 4 maj 2007, dhe se përgjegjësia e UNMIK-ut në fushën e sundimit të së drejtës, duke përfshirë edhe funksionimin e gjykatave, pushoi më 9 dhjetor 2008. Si pasojë periudha kohore që lidhet me këtë element të kërkesës ishte 20 muaj gjatë së cilës kohe UNMIK-u ka ushtruar përgjegjësitë. Prandaj, PSSP-ja konkludon se "periudha prej 20 muajsh ndërmjet dorëzimit të kërkesës dhe përfundimit të përgjegjësive të UNMIK-ut në fushën e sundimit të së drejtës nuk përbën një vonesë të tepruar".

41. Paneli është në dijeni për faktin se më 9 dhjetor 2008, përgjegjësitë e UNMIK-ut lidhur me gjyqësorin në Kosovë përfunduan me marrjen e kontrollit të plotë operacional në fushën e sundimit të së drejtës nga Misioni i Bashkimit Evropian për Sundimin e Ligjit (EULEX). Për rrjedhojë, nga 9 dhjetori 2008, UNMIK-u nuk mund të mbahet më përgjegjës për veprimet apo mosveprimet e gjykatave në Kosovë.

42. Paneli thekson se periudha ndërmjet 4 majit 2007 dhe 9 dhjetorit 2008 paraqet përafërsisht 20 muaj. Paneli nuk konsideron se gjatë kësaj periudhe ka pasur vonesë aq të gjatë sa të jetë e paarsyeshme.

43. Prandaj, Paneli e konsideron këtë pjesë të ankesës të pabazuar në shikim të parë në kuptim të nenit 3.3 të Rregullores së UNMIK-ut nr. 2006/12.

d) Diskriminimi i pohuar sipas nenit 14 të KEDNJ

44. Ankuesi pohon se është diskriminuar sa i përket pagesës së pensionit. Në mënyrë më specifike, ankohet se serbët e Kosovës kanë vazhduar marrjen e rregullt të fondit pensional kurse shqiptarëve të Kosovës ju ndalua krejtësisht marrja e çfarëdo pagese.

45. Në komentet e tij, PSSP-ja thekson se UNMIK-u nuk kishte kompetenca apo kontroll lidhur me pensionistët serbë të cilët jetonin në Kosovë dhe merrnin pensionet e tyre rregullisht nga Beogradi. Prandaj, çfarëdo praktike e pohuar diskriminuese në përzgjedhjen e përfituesve dhe pagesën e pensioneve nuk mund t'i ngarkohet UNMIK-ut, dhe prandaj Paneli nuk ka juridiksion *ratione personae* për këtë pjesë të ankesës.

46. Paneli thekson se përderisa ankuesi ankohet kundër faktit se Fondi Pensional dhe Invalidor me seli në Beograd vazhdon pagesën e pensioneve të fituara në kuadër të sistemit pensional të ish Jugosllavisë në favor të serbëve të Kosovës, që siç pohohet vepron në mënyrë diskriminuese, veprimet e tilla u ngarkohen ekskluzivisht autoriteteve serbe dhe në asnjë mënyrë nuk përfshijnë përgjegjësinë e UNMIK-ut. Prandaj, Paneli konsideron se kjo pjesë e ankesës është jashtë juridiksionit *ratione personae* të Panelit në kuptim të nenit 1.2 të Rregullores së UNMIK-ut nr. 2006/12.

PË KËTO ARSYE,

Paneli unanimisht,

- **E SHPALL TË PRANUESHME ANKESËN SIPAS NENIT 1 TË PROTOKOLLIT NR. 1 TË KONVENTËS EVROPIANE PËR TË DREJTAT E NJERIUT;**

- **E SHPALL TË PRANUESHME ANKESËN SIPAS NENIT 3 TË KONVENTËS EVROPIANE PËR TË DREJTAT E NJERIUT DHE SIPAS NENEVE 9 DHE 11 TË KONVENTËS EVROPIANE PËR TË DREJTAT EKONOMIKE, SOCIALE DHE KULTURORE;**

- **E SHPALL TË PAPRANUESHME PJESËN TJETËR TË ANKESËS**

Andrey ANTONOV Zyrtar ekzekutiv	Marek Nowicki Kryetar